



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Korrik, 2025

01-31 korrik, 2025

PËRMBAJTJA E
BULETINIT

- 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit korrik 2024 dhe 2025
- 2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
- 3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
- 4. Epidemitë e lajmëruara
- 5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
- 6. COVID-19
- 7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA
SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT KORRIK
2025 DHE 2024

Gjatë muajit korrik 2025 janë raportuar **16,916 raste** me sëmundje ngjitëse **Inc.(949.21 raste /100, 000 banorë)**. Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit **2024 (23,628 raste apo Inc 1325.84 raste/100,000)**. Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: **Diare ac. me 11,216 raste ose 629.36/100,000 Influenca sezonale (ILI) me 4,121 raste ose 231.24/100,000 banorë, banorë, dhe ARI/ITPR me 713 raste ose 40.01 në 100,000 banorë (Tab.1).**

Gjatë muajit korrik 2025 janë raportuar 4 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 3 raste me dg. Infiltratio pulmonum me diagnozë përcjellëse dhe 1 rast me dg. Sepsis dhe sëmundje shoqëruese

2. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË SIPAS KOMUNAVE, KORRIK 2025

Gjatë muajit qershor 2025 në IKShPK, nga grupi i sëmundjeve që raportohen me numrin më të lartë, (shih Tabela 1)

Diarea akute: Gjatë muajit korrik 2025 në IKShPK janë raportuar 11,126 raste me sindromë diareale (Inc.629.36/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (16,089 raste), vërehet një ulje prej mbi 30.28% por krahasuar me muajin qershor 2025, me 4,179 raste të raportuara, rritje trefishe e numrit të rasteve të raportuara. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë gjatë kësaj periudhe të vitit.

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit korrik 2025 në IKShPK janë raportuar 4,121 raste me ILI (Inc. 231.24/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rënie prej 27.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (5,688 raste) por krahasuar me muajin paraprak, qershor 2025 me (3,254 raste të raportuara me ILI) vërehet rritje prej 26.6%, karakteristike kjo për rritje të qarkullimit të patogjenëve respirator.

ARI/ITPR: Gjatë muajit korrik 2025 në IKShPK janë raportuar 713 raste me ARI (Inc.40.01/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (858 raste) vërehet ulje prej 16.9% e numrit të rasteve të raportuara por krahasuar me muajin paraprak qershor 2025 me (849 raste), ulje prej 16.01%.

Variçella: Gjatë muajit korrik 2025 në IKShPK janë raportuar 404 raste me Variçellë (Inc.22.67/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (544 raste) vërehet ulje prej 25.7% e rasteve të raportuara por krahasuar me muajin paraprak qershor 2025 me 340 raste të raportuara, rritje prej 18.8%.

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve të raportuar në Kosovë, 01 – 31 korrik të vitit 2024 dhe 2025

Tabela 1.

Numri i rasteve dhe Incidenca e disa sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve në Kosovë				
në periudhën 01 - 31 korrik të vitit 2024 dhe 2025				
Sëmundjet ngjitëse/shkaktarët	Korrik, 2024		Korrik, 2025	
	Nr.	Incidenca/100.000	Nr.	Incidenca/100.000
COVID-19	88	4.94	9	0.51
ITPR - Pneumonia/ARI	858	48.15	713	40.01
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	8	0.45	14	0.79
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	5688	319.17	4121	231.24
Diarea acute	16089	902.80	11216	629.36
Variçela	544	30.53	404	22.67
Sindromi meningjeal	20	1.12	19	1.07
Helmimet me ushqim	145	8.14	142	7.97
Rota virus	2	0.11	7	0.39
Salmonella enteritidis	3	0.17	5	0.28
Adenovirus	14	0.79	3	0.17
Gastroenterokolitet	63	3.54	111	6.23
Clostridium difficile	3		3	0.17
E.coli	1		1	0.06
Hepatiti akut B	2	0.11	2	0.11
Hepatiti akut C		0.00	1	0.06
Morbilli		0.00	19	1.07
Parotiti epidemik	2	0.11	3	0.17
Pertussis	32	1.80		0.00
Rubella			1	0.06
Brucelosis	4	0.22	8	0.45
Tularemi		0.00	1	0.06
Toxoplasmosis		0.00	1	0.06
Sëmundja Lyme		0.00	4	0.22
HIV/AIDS		0.00	5	0.28
IST	22	1.23	29	1.63
TB		0.00	24	1.35
Giardiaza	1	0.06	2	0.11
Entameba hystolitica	1	0.06		0.00
Infeksionet streptococcica të grupit A			18	1.01
*Sëmundjet tjera ngjitëse	38	2.13	30	1.68
Gjithsej	23628	1325.84	16916	949.21
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mononucleoza				

Grupi i sëmundjeve të raportuara në mënyrë individuale:**Sëmundjet vaksinëpreventabile:**

Gjatë muajit korrik 2025, janë raportuar 21 raste të dyshimta me fruth ku 19 prej tyre janë konfirmuar me laborator si raste pozitive. Nga rastet e konfirmuara, 7 prej tyre janë identifikuar si raste index dhe 12 raste kontakte të tyre si tregues për përhapje në komunitet. Sipas komunave: Prishtinë (17 raste), Malishevë (1 rast), Prizren (1 rast) ku 18 prej tyre janë të pavaksinuar me vaksinën MMR. Sipas gjinisë 10 i përkasin gjinisë mashkullore kurse 9 gjinisë femërore. Sipas grup-moshës: 0-1 vjeç; (2 raste) që përbëjnë 10% të rasteve, 1-2 vjeç; (3 raste) që përbën 16% të rasteve, 3-5 vjeç; (7 raste) që përbën 37% të rasteve dhe mbi 6 vjeç; (7 raste), që përbëjnë 37% të rasteve.

Gjatë muajit korrik 2025, nga laboratori mikrobiologjik i IKShPK-së, janë konfirmuar 3 raste pozitive me Parotitis epidemica. Rastet e konfirmuara janë nga komunat: 2 nga Prishtina, 1 nga Gjakova. Sipas grup-moshës 2 raste i takojnë grup-moshës 1-4 vjeç dhe 1 rast grup-moshës >18 vjeç. Të gjitha rastet i takojnë gjinisë mashkullore. Gjatë hulumtimit epidemiologjik kemi siguruar të dhëna se 2 prej tyre kanë status të rregullt vaksinal.

Nga laboratori mikrobiologjik i IKShPK-se, gjatë kësaj periudhe është konfirmuar një rast pozitiv me Rubellë. Rasti është nga komuna e Prishtinës, e gjinisë femërore me grup moshë 0-2 vjeç.

Zoonozat dhe sëmundjet transmise:

Gjatë muajit korrik 2025, nga ky grup i sëmundjeve janë raportuar 8 raste me Brucellozë dhe me nga 1 rast: Tularemi dhe Toxoplazmozë. Sipas komunave rastet me Brucellozë janë: Prizren (2 raste), Dragash (3 raste), Lipjan (1 rast) Mamushë (1 rast) dhe Prishtinë (1 rast). Nga anketimi epidemiologjik rezulton se, 3 nga rastet me brucellozë janë anëtarë të një familje, pra kishim të bëjmë me një epidemi familjare, nga Dragashi i Prizrenit të cilët kanë në pronësi një fermë lopësh. Për këtë epidemi familjare është njoftuar AUV dhe janë ndërmarrë masat e nevojshme në asgjësim të kafshëve pozitive. Rastet tjera janë raste sporadike, pa ndonjë lidhshmëri epidemiologjike.

Rasti me Tularemi është nga komuna e Fushë Kosovës dhe mohon kontaktin me brejtës ndërsa ai me Toxoplazmozë nga komuna e Vitisë.

Sëmundjet që barten përmes vektorëve:

Gjatë muajit korrik janë raportuar 4 raste me borreliozë, prej të cilave 2 raste nga komuna e Prishtinës, 1 rast Lipjan dhe 1 rast Vushtrri. Tre raste janë të gjinisë femërore dhe 1 rast i gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës 2 raste janë të grup moshës 20-29 vjeç, 1 rast i grup moshës 40-49 vjeç dhe 1 rast i grup moshës 50-59 vjeç.

Sindroma meningjeale:

Gjatë muajit korrik, 2025 janë raportuar 19 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 1.06/100 000 banorë), prej tyre 13 raste me Meningjit viral, 6 raste me Meningjit bakterial. Ky numër i rasteve të raportuara është përafërsisht i njëjtë krahasuar me periudhën e vitit 2024, ku ishin raportuar 20 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 1.12/100 000 banorë), prej tyre 13 raste me Meningjit akut viral dhe 5 raste me Meningjit bakterial, 2 raste me Mumps meningjit.

Sipas komunave, 10 raste janë raportuar në komunën e Prishtinës, 3 raste Lipjan, 2 raste komuna e Vushtrrisë, kurse me nga 1 rast komunat: Prizren, Ferizaj, Malishevë, Fushë Kosovë. Sa i përket grup-moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se numri më i madh i rasteve i takon grup-moshës 0-9 vjeç 57.8% (11 raste), grup moshat 10-19 vjeç, 30-39 vjeç dhe 50-59 vjeç 10.5% (2 raste secila) kurse grup moshat 20-29 vjeç dhe 60-69 vjeç me nga 1 një rast të raportuar (5.2%). Sipas gjinisë, rezulton se 47.3% (9 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe të gjinia femërore me 52.7% (10 raste). Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK në LCS janë izoluar: 4 raste me HHV7, 2 raste me Neisseria

meningitidis, 1 rast me Streptococcus pneumoniae, 1 rast me Acenitobacter baumannii, 2 raste me Mumps virus, 2 raste me HHV 6, 2 raste me Human Enterovirus, 1 rast me Haemophilus influenzae, 1 rast me Human Adenovirus dhe 1 rast me Variçella Zoster virus.

Gjatë kësaj periudhe kohore nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me Syndromë Meningjeale.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim:

Gjatë muajit korrik 2025, përmes SMSN nga regjioni i Prishtinës janë raportuar: 813 raste me dg. Diarea dhe gastroenteritet me origjinë infektive të supozuar (AO9); 2 raste me dg. Infeksionet tjera intestinale bakteriale me shkaktarë të paspecifikuar (AO4.8); 1 rast me dg. Infeksionet virale dhe infeksionet tjera specifike intestinale (AO8.O); 1 rast me dg. Salmonella (Salmonella spp.) (AO2.O); dhe 1 rast me dg. Intoksikacionet tjera alimentare bakteriale (AO4.9).

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar:

5 raste me Salmonella Enteritidis prej të cilave sipas komunave janë: 2 raste Prishtinë, 2 raste Podujevë dhe 1 rast Lipjan. Sipas grup moshave 2 raste janë të grup moshës 30-39 vjeç dhe nga 1 rast i grup moshave 20-29 vjeç, 50-59 vjeç dhe 60-69 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 2 raste janë të gjinisë femërore dhe 3 raste të gjinisë mashkullore.

7 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 4 raste Prishtinë, 1 rast Mitrovicë, 1 rast Gjakovë dhe 1 rast Vushtrri. Sipas grup moshave të 7 rastet janë të grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 3 raste janë të gjinisë femërore dhe 4 raste të gjinisë mashkullore.

3 raste me Adenovirus, prej të cilave sipas komunave janë: 1 rast Prizren, 1 rast Gjakovë dhe 1 rast Junik. Sipas grup moshave të tre rastet janë të grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 1 rast i gjinisë femërore dhe 2 raste të gjinisë mashkullore.

3 raste me Clostridium difficile, prej të cilave sipas komunave janë: 1 rast Prishtinë, 1 rast Vushtrri dhe 1 rast Klinë. Sipas grup moshave nga 1 rast i takon grup moshave 30-39 vjeç, 50-59 vjeç dhe 60-69 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 2 raste të gjinisë femërore dhe 1 rast i gjinisë mashkullore.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit korrik 2025, nga qendrat sentinel janë testuar 152 mostra të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respirator.

Nga mostrat e testuara nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv me Infleuncë A,B dhe RSV. Nga patogjenët tjerë respirator janë konfirmuar 44 mostra pozitive me Human Adenovirus (ADV) apo 28.94%, 16 mostra pozitive me Human Rhinovirus (HRV) apo 10.5% dhe 4 mostra pozitive me Parainfluenza Virus (PIV) apo 2.6 %. (Grafikoni 1)

Mbikëqyrja me Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë vazhdon sipas rekomandimeve të ECDC dhe OBSH për Influcencë me të dhënat e përditësuara nga mbikëqyrja epidemiologjike dhe virologjike. Duke pasur parasysh mungesën e sezonalitetit të parashikueshëm të SARS-CoV-2 dhe potencialin për rritje të aktivitetit edhe gjatë muajve pranverorë dhe verorë, mbikqyrja aktive duhet të vazhdojë gjatë gjithë vitit, në përputhje me udhëzimet e ECDC dhe OBSH.

Intensiteti i Influcencës Sezonale për muajin korrik 2025 paraqitet në nivel të ulët të aktivitetit të qarkullimit. Gjatë këtij muaji nuk është raportuar asnjë rast pozitiv. Ky nivel i ulët i qarkullimit është në përputhje me tendencën sezonale të kësaj periudhe të vitit.

Gjatë muajit korrik 2025, përmes raportimit në kohë reale nga Kl. Infektive dhe përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN), u raportuan gjithsej 14 raste me SARI (Inc.o.79/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (8 raste) vërehet rritje e numrit të rasteve të raportuara. Të gjitha rastet u testuan së paku në tre

viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influcencë dhe RSV. Prej tyre rezultuan 1 mostër pozitive në SARS-CoV-2, 4 mostra pozitive në Human Adenovirus (ADV) dhe 3 mostra pozitive në Human Rhinovirus (HRV).

Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (5 raste), Vushtrri (2 raste), Lipjan (2 raste), Glogoc (2 raste) dhe me nga një rast komunat Ferizaj, Malishevë dhe Skenderaj.

Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është: 0-4 (12 raste) dhe mbi 65 vjeç (2 raste). Sipas gjinisë, 10 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 4 gjinisë femërore. Rastet e vdekjes i përkasin komunave si : Prishtinë (3 raste), Gjakovë (1 rast), Podujevë (1 rast), Kamenicë (1 rast) dhe Gjilan (1 rast), i takojnë grup-moshës: mbi 65+ (3 raste), 51-64 (2 raste) 35-50 vjeç (2 raste).

Në SMSN, gjatë muajit korrik 2025, janë raportuar 24 raste me Tuberkuloz apo 1.34 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Prishtinë (19 raste), Pejë (3 raste), Gjilani dhe Lipjan me nga (1 rast). Prej 24 rasteve të raportuara, 19 (79.1%) janë raste pulmonare dhe forma ekstrapulmonare 5 (20.9%). Nga forma pulmonare, të konfirmuara bakteriologjikisht janë 9 raste (37.5%). Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se grup- mosha më e prekur është ajo 60-69 vjeç me 8 raste apo (33.3%), 20-29 vjeç dhe 30-39 vjeç me nga 4 raste (16.6%), grup mosha 40-49 vjeç dhe 50-59 vjeç me nga 3 raste apo (12.5%), kurse grup mosha 15-19 vjeç me 2 raste (8.33%). Sipas gjinisë, rezulton se 54.1 % (13 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe gjinia femërore me 45.2% (11 raste).

Rastet me HIV/AIDS/IST, korrik 2025

Gjatë muajit korrik 2025, janë raportuar 5 raste me HIV. Të gjitha rastet i takojnë gjinisë mashkullore. Një rast i takon grup moshës 15-24 vjeç dhe katër raste tjera grup moshës 25-34 vjeç. Rruga e transicionit për dy raste është e homoseksuale, dy raste heteroseksuale, dhe për një rast nuk është e raportuar.

Dy raste janë nga komunat e Prishtinës, një Mitrovicë, një Malishevë dhe për një rast nuk është e raportuar komuna.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST), qershor 2025

Gjatë muajit korrik 2025 janë raportuar gjithsej 29 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj 13, Prishtinë 6, Prizren 3, Gjakovë 2, Rahovec 2, Hani i Elezit 1, Suharekë 1 dhe Lipjan 1 rast. Sipas diagnozës: Chlamydia 17 raste, Condyloma 7, Gonorrhoeae 3 dhe Sifilis 2 raste. Sipas gjinisë: 18 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 11 raste gjinisë mashkullore. Grup moshës: 25-49 vjeç i takojnë 24 raste, grup moshës 15-24 vjeç 3 raste dhe dy raste mbi 50 vjeç

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C, korrik 2025

Gjatë muajit korrik, 2025, janë raportuar 2 raste me Hepatit akut B. 1 rast nga komuna e Vushtrrisë (67 vjeç) i gjinisë mashkullore dhe 1 rast nga komuna e Kaçanikut (36 vjeç) e gjinisë femërore.

Me Hepatit akut C, gjatë kësaj periudhe është raportuar një rast nga Prizreni (52 vjeç) e gjinisë femërore.

Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, korrik 2025

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, korrik 2025																																	
SËMUNDJA	Sindroma meningjeale										Morbilli	Parotitis epidemic a	Rubeolla	Hepatit ac. B	Hepatit ac. C	Helmint me ushqim	Gastroe nterokol itet	Bruceloz a	Tularem i	Salmonel loza	E.coli	Rotavir us	Borelioz a (Lyme Disease)	Toxoplasmosis	Adenovirus	Cl.Difficile	IST	HIV	TB	Giardia za	Infeksionet streptokokstë gr. A	Sëm.tjera ngjitëse	Totali
	Pneumonia/ARI	SARI	ILI	Diarheja ac	Varicella	COVID-19	Meningjit sersosa	Meningj it purulent	Meningj it encephal it ac.	Mumps meningit is																							
KOMUNA																																	
DEÇAN	0		12	154	1									24																1		192	
DRAGASH	6		16	197	1											3																223	
DRENAS	17	2	11	39									2	2																	1	74	
F. KOSOVË	3		62	135	4	1				1				1	5		1													3	1	217	
FERIZAJ	6	1	491	627	10			1						5	39										13					2		1195	
GJAKOVË	11		30	102	7							1		8	11						1			1		2				3		177	
GJILAN	11		155	656	30																										3	853	
GRAÇANICË																																0	
H. I ELEZIT	0		13	27	1																					1						42	
ISTOG	5		91	191	3									2	1																1	294	
JUNIK	0		5	25	3																			1								35	
KAÇANIK	2		64	150	1							1				5															1	223	
KAMENICË	0		200	367	0																											567	
KLINË	14		49	175																					1							239	
KLLOKOT																																0	
LEPOSAVIQ																																0	
LIPJAN	1	2	9	84	1		2		1							2	1		1				1			1					1	108	
MALISHEVË	0	1	16	72	8						1	1				4							1				1					104	
MAMUSHË			8	34	11												1															1	55
MITROVICË	17		391	1180	29																1					1					2	1621	
MITROVICË E V.																																0	
N. BËRDË	0		19	13	0																												32
OBILIQ	0	0	78	64	6											2																150	
PARTESH																																0	
PEJË	12		468	1166	35									8														3	1			1693	
PODUJEVË	6		91	281	8										1				2												2	392	
PRISHTINË	559	5	1174	2686	132	8	6	3		1		17	2	1		18	32	1		2		4	2		1	6	2	19		3		4684	
PRIZREN	11		92	1315	68		1					1		10			2							1			3				11	1516	
RAHOVEC			26	128	13																					2						1	170
RANILLUG																																0	
SHTËRPCE															1																	1	
SHTIME	9		104	191	5										5																	314	
SKËNDERAJ	3	1	30	110	1									1																		146	
SUHAREKË	9		194	544	11																				1							759	
VITI	0		195	283	14																		1									493	
VUSHTRRI	11	2	27	220	1		1				1			63	1				1	1	1	1		1						2	12	346	
Z. POTOK																																0	
ZVEÇAN																																0	
BURGU I LIPJANIT																																0	
PAADRESË																										1						1	
TOTALI	713	14	4121	11216	404	9	10	4	1	2	2	19	3	1	2	142	111	8	1	5	1	7	4	1	3	3	29	5	24	2	18	30	16916
*Sëmundjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza, HFMD																																	
** Raste të importuara																																	

*Sëmudjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza, HFMD

** Raste të importuara


3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRI DHE SPITALET RAJONALE NGA SËMUNDJET NGJITËSE NË KOSOVË GJATË MUAJIT KORRIK 2025

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar nga diaretë akute dhe gastroenterokolitet nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar nga exanthemat, pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë, të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih tabela 3).

Rastet e spitalizuara në Klinikën Infektive, Pediatri dhe spitalet rajonale nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë, gjatë muajit korrik 2025

Tabela 3.

Sëmundja	Rastet
Pneumonia /ARI	78
SARI	14
Hepatitis B	2
Sindroma meningjeale	19
Helmimet me ushqim	28
Diarea akute dhe gastroenterocolite	374
Status febrilis	26
Exanthema	155
Mononucleosis	3
Erysipela	17
Vulnus morsum viperi	3
Gjithsej	719



4. EPIDEMITË E LAJMËRUARA GJATË MUAJIT KORRIK 2025

Epidemia kolektive në Ferizaj

Epidemia ka filluar më datë me datë 29.06.2025 dhe është zbuluar më datë 03.07.2025 nga Klinika Infektive ku janë raportuar dy raste me Dg. Gastroenterocolitis acuta. Pacientët i takojnë grup moshës 18 dhe 24 vjeç (motër e vëlla) me vendbanim në Ferizaj, të hospitalizuar më 02.07.2025, me simptome ethe, temperaturë, kokëdhembje, mundim, vjellje, barkqitje dhe dhimbje të forta barku. Këto simptome ju kanë filluar me datë 29.06.2025. Fillimisht janë trajtuar në QKMF Ferizaj pastaj udhëzohen në Klinikën Infektive në QKUK. Të njëjtët në anketë epidemiologjike kanë deklaruar se kanë konsumuar: hamburger me mish viçi dhe majonez në lokalin ” N.N.” në magjistralen Prishtinë- Shkup në Ferizaj më dt: 27.06.2025 në ora 20.00. Të njëjtin ushqim e kanë ngrënë edhe 2 anëtarë tjerë të familjes, të cilët kanë pasur simptoma të ngjashme, të cilët janë trajtuar në mënyrë ambulatorike në QKMF, Ferizaj dhe gjendja e tyre është stabilizuar. Nga pacientët e hospitalizuar në Klinikën infektive janë marrë mostra për koprokulturë në laboratorin e Mikrobiologjisë në Klinikën Infektive.

Ekipi i QRSHF Ferizaj në bashkëveprim me Inspektorati Sanitar kanë vizituar restaurantin në fjalë me datë 03.07.2025 në ora 13:30, me ç’rast janë marrë 7 mostra/strisho për sterilitet për vlerësimin e kushteve higjieniko- sanitare nga ambienti i kuzhinës, në enë, në tavolina të punës, në aparate të përgatitjes së ushqimit, si dhe nga uniformat dhe duart e kuzhinierëve, të cilat janë sjellë po atë ditë në laboratorin e QRSHF për analizë dhe 3 mostra të ushqimit: sallatë me lakër, majonez i përgaditur në restorant, dhe qebapa. Me urdhër të Inspektoratit Sanitar, është rekomandu që prej orës 18:00 të mbyllet lokali dhe të bëhet një DDD dhe një pastrim gjeneral. Është marrë një mostër e ujit për analizë fiziko- kimike dhe bakteriologjike dhe është dërguar në QRSHF, Ferizaj për analizë. Është urdhëruar kontrolla sanitare (librezë sanitare) te punëtorët të cilë nuk kanë qenë të paisur. Janë marrë 3 mostra të ushqimit dhe janë dërgu në laboratorin e Mikrobiologjisë në Departamentin e Ekologjisë Humane në IKSHPK për analizë.

Rezultatet deskriptive: Në restorant gjatë 24 orëve shërbehen afërsisht 500 shujta. Katër (4) raste kane shfaqur simptome gastrointestinale të cilët kanë kërkuar ndihmë mjekësore (shkallë sulmi 0.8 %). Nga 4 rastet e raportuara janë anketuar 2 raste.

Sa i përket simptomatologjisë, kryesisht kanë dominuar rastet me 3 e më shumë simptome në të njëjtën kohë si: vjellje, diarre ujore, mundim, temperaturë, ethe dhe kokëdhembje. Sipas gjinisë: 2 femra, 2 meshkuj, grupmoshat e përfshira janë me nga 1 rast: 10-19 vjeç, 20- 29 vjeç, 30-39 vjeç dhe 60-69 vjeç, 2 raste janë hospitalizuar, 2 të tjerë janë trajtuar në menyre ambulantore.

Rezultatet laboratorike: Në Laboratorin e Mikrobiologjisë në Klinikën Infektive të QKUK-së, janë dërguar për analizë 2 mostra të fecesit të marra nga rastet e hospitalizuara dhe të 2 mostrat nuk janë izoluar baktere patogjene. Në laboratorin e Mikrobiologjisë në Departamentin e Ekologjisë Humane në IKSHPK, nga 3 mostrat e ushqimit të analizuar, në mostrën me sallatë lakre është izoluar: *E.coli* në 0.01 gr/ml- 2000 cfu, Baktere koliforme 0.01 gr/ml- 1500 cfu, numri i përgjithshëm i baktereve të gjalla mezofile 0.01 gr/ml >300 cfu. Në mostrën me majonez është izoluar: Baktere koliforme 0.01 gr/ml- >300 cfu, numri i përgjithshëm i baktereve të gjalla mezofile 0.01 gr/ml >300 cfu.

Sa i përket strishove të marra në ambientet e lokalit, nga mjetet e punës, enët, aparatete dhe personeli prej 7 strishove të marra, në 3 prej tyre janë izoluar: Strisho nga tavolina e punës: - *Enterococcus* spp., Strisho nga pjata e pastër: - *Enterococcus* spp., strisho nga duart e kuzhinieri t- *S. Aureus*. Analiza e ujit nga aspekti fiziko- kimik është brenda standardeve për ujin e pijes UA 10/2021, ndërsa nga aspekti bakteriologjik ks nr mbi vlerat e lejuara të baktereve mezofile.

Epidemia kolektive në Ferizaj

Epidemia ka filluar më datë me datë 28.07.2025 dhe është zbuluar më datë 28.07.2025 nga Klinika Infktive ku është raportuar një rast me Dg: Intoxicatio alimentaris. Pacienti i lindur më 2004 me vendbanim në Veternik- Prishtinë, hospitalizohet në Klinkën Infektive me simptomat: ethe, temperaturë, kokëdhimbje, mundim, vjellje, barkqitje dhe dhimbje të forta barku. Këto simptoma i kanë filluar me datën 28.07.2025 në orët e para të mëngjesit. Sillet fillimisht në Qendrën Emergjente dhe pas konsultimit me Infektologun hospitalizohet në Klinikën Infektive. Gjatë anketimit epidemiologjik kuptojmë se pacienti ka ngrënë darkë në datën 26.07.2025 rreth orës 19:00 në restaurantin "N.N." në Brezovicë. Ushqimi që ka konsumuar ishte: qofte me mish viqi, mantija dhe tavë Elbasani. Një ditë më vonë i fillojnë simptomet e lartë përmendura. Të njejtin ushqim e kanë ngrënë edhe tre shokët e tij me të cilë po udhëtonte, të cilët po ashtu kishin simptoma të ngjajshme si vjellje, dhimbje barku dhe barkqitje të përcjellura me temperaturë por nuk kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Pacientit i janë marrë mostra gjaku dhe mostra për koprokulturë për hulumtime laboratorike.

Rezultatet laboratorike: Në Laboratorin e Mikrobiologjisë në Klinikën Infektive të QKUK-së, është dërguar për analizë 1 mostër e fecesit dhe nuk është izoluar baktere patogjene. Në laboratorin e Mikrobiologjisë në QRShP Ferizaj, sa i përket strishove të marra në ambientet e lokalit, në strishon nga thika është izoluar *Enterococcus* spec. dhe *Staphylococcus Aureus*, në strishon e dërrasës së punës-mishit është izoluar *Staphylococcus Aureus* dhe *Enterococcus* spp., në strishon e dërrasës e sallatës:- *Staphylococcus Aureus* dhe *Enterococcus* spp. Mostrat e ushqimit nuk janë marrë për analizë

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, kanë raportuar 29 komuna ose 76.31% (29/38) e tyre. Komunitat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Kllokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, korrik 2025

KOMUNA	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucionet Private	QKTGJ	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej
DEÇAN								94			94
DRAËASH								2			2
DRENAS								28	4		32
F. KOSOVË								53	2	66	121
FERIZAJ	2							6	22		30
GJAKOVË	39					18		52	97		206
GJILAN	17							20	29		66
GRAÇANICË											0
H. I ELEZIT								8			8
ISTOG								19			19
JUNIK								18			18
KAÇANIK								3			3
KAMENICË								28			28
KLINË								18			18
KLLOKOT											0
LEPOSAVIQ											0
LIPJAN								105	1		106
MALISHEVË								84			84
MAMUSHË											0
MITROVICË									69	1	70
MITROVICË E VERIUT											0
N. BËRDË								5			5
OBILIQ								59	7	3	69
PARTESH											0
PEJË	6							65	31		102
PODUJEVË								72	39		111
PRISHTINË		56	22		13	4	2	9	437	1	544
PRIZREN	97							66	102		265
RAHOVEC									140	14	154
RANILLUG											0
SHTËRPCE											0
SHTIME											0
SKËNDERAJ								38			38
SUHAREKË											0
VITI								142			142
VUSHTRRI	75							43	41		159
Z. POTOK											0
ZVEÇAN											0
Gjithsej	236	56	22	0	13	22	2	1037	1021	85	2494


Gjatë muajit korrik 2025, përmes SMSN janë raportuar gjithsej 2,494 raste me sëmundje ngjitëse. Ky numër krahasuar me numrin e rasteve të raportuara me kopje fizike shënon një rritje prej 14.74 % të rasteve të raportuara përmes SMSN.

6. COVID-19

Gjatë muajit korrik 2025, janë testuar gjithsej 324 mostra të dyshimta për COVID-19, nga të cilat janë raportuar 9 raste pozitive me SARS-CoV-2, me një shkallë të pozitivitetit prej 2.7% dhe krahasuar me muajin korrik 2024 (me 437 testime dhe 88 raste pozitive), vërehet ulje e numrit të rasteve pozitive dhe testimeve.

Nga 9 rastet e raportuara, sipas komunave: Prishtinë (8 raste) dhe Fushë Kosovë (1 rast), sipas gjinisë: 4 raste (gjinisë femërore apo 44.4%) dhe 5 raste (gjinisë mashkullore apo 55.5%). Sipas grup-moshës: 50–59 vjeç me 3 raste, 0–9 vjeç dhe 40–49 vjeç me nga dy raste dhe grup-mosha 10–19 vjeç dhe 70–79 vjeç me nga 1 rast dhe krahasuar me muajin korrik 2024 (me 437 testime dhe 88 raste pozitive), vërehet ulje e numrit të rasteve pozitive dhe testimeve.

Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara, të konfirmuara me COVID-19, qershor 2025



7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE BOTË, KORRIK 2025

Rritje e lehtë e rasteve të COVID-19 në BE/EEA dhe shfaqjen e një variant të ri

Gjatë javëve të fundit janë raportuar rritje të lehta të aktivitetit të SARS-CoV-2 nga nivelet bazë në shumë vende të BE/EEA. Numri i rasteve në kujdesin parësor mbeten në ose nën nivelet që vërehen zakonisht gjatë kësaj periudhe, si dhe në krahasim me sezonet e kaluara. Është e rëndësishme të theksohet se deri më tani nuk është vërejtur asnjë ndikim i rëndësishëm në sëmundjeve të rënda respiratore - siç janë pranimet në spital, pranimet në njësinë e kujdesit intensiv ose vdekjet nga SARS-CoV-2.

Mbulimi i vaksinimit COVID-19 tek të rriturit e moshuar mbetet jo optimal në disa vende të BE/EEA, me vetëm një vend që tejkalon 80% mbulim midis atyre 80 vjeç e lart, dhe shtatë vende që arrijnë më shumë se 50% mbulim. ECDC rithekson se vaksinat COVID-19 vazhdojnë të ofrojnë mbrojtje të fortë kundër pasojave të rënda nga COVID-19. Është e rëndësishme që grupet e rrezikut, përfshirë të moshuarit, të kenë vaksinat e tyre COVID-19 sipas rekomandimeve kombëtare për të rritur mbrojtjen kundër sëmundjeve të rënda.

Mbikëqyrja e Virusit të Nilit Perëndimor në rajonin evropian, 2025

Që nga fillimi i vitit 2025, dhe që nga 6 gushti 2025, 6 vende në Evropë raportuan raste humane të infeksionit nga virusi i Nilit Perëndimor. Këto vende janë Bullgaria, Franca, Greqia, Hungaria, Italia dhe Rumania. Raporti aktual në tregon numrin e rasteve të mundshme dhe të konfirmuara të infeksioneve të WNV për rajonin NUTS3. Megjithatë, këto shifra janë paraprake dhe duhet të interpretohen me kujdes pasi ato mund të përditësohen vazhdimisht nga vendet e lartcekura ndërsa bëhen të disponueshme më shumë informacione. Si pasojë, nuk ofrohen totale. Për detaje të mëtejshme mbi numrat e rasteve, ju lutemi referojuni raportit të përbashkët mujor, i cili ofron një analizë më të detajuar. Infeksioni i virusit të Nilit Perëndimor tek njerëzit është një sëmundje e raportueshme në nivelin e BE dhe rastet raportohen në përputhje me përkufizimin e rastit të BE. Raportet dhe hartat nga ECDC tregojnë vendet dhe zonat ku rastet njerëzore të infeksionit WNV janë raportuar dhe ato përditësohen në portalin evropian të mbikëqyrjes për sëmundjet infektive (shiko në EpiPulse).

Mbikëqyrja sezonale e sëmundjes së virusit Chikungunya në BE/EEA

Që nga fillimi i vitit 2025 dhe që nga 6 gushti 2025, dy vende në Evropë kanë raportuar raste të sëmundjes së virusit Chikungunya: Franca (63) dhe Italia (2). Deri më sot, në vitin 2025, autoritetet e shëndetit publik në Francë kanë raportuar 63 raste të sëmundjes së virusit chikungunya të fituara në vend në 16 njësi të ndryshme administrative lokale. Krahasuar me javën 31, numri i grupeve të infeksionit (clusters) u rrit me dy në javën 32. Rastet u raportuan për herë të parë në departamentin Pyrenees-Atlantiques (tre raste në një grup). Tre raste që përfaqësojnë një grup të ri u raportuan në Gard. Dy raste të reja u raportuan në grupe aktive në departamentet Corse-du-Sud, Isère, Hérault dhe Bouches-du-Rhône, secili. Njëmbëdhjetë grupe klasifikohen aktualisht si aktive. Grumbullimet më të mëdha ndodhen në Salon-de-Provence, Grans dhe Lambesc në departamentin Bouches-du-Rhône dhe Grosseto-Prugna në departamentin Corse-du-Sud, dhe të dyja përbëhen nga 13 raste. Këtë javë (java 31) Italia nuk raportoi raste të reja të sëmundjes së virusit chikungunya, të fituara në vend. Dy grupet me nga një rast në të dyja mbeten aktive.

Rrezik i shtuar i infeksioneve me *Vibrio cholerae* gjatë sezonit të verës

Gjatë stinës së verës dhe rritjen e temperaturave të sipërfaqes së detit, Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) po thekson rrezikun sezonal të paraqitur nga bakteret *Vibrio*. Bakteret jetojnë natyrshëm në ujërat bregdetare të kripura, ku uji i kripur dhe ai i ëmbël përzihen, veçanërisht kur temperaturat janë të larta dhe kripa është më e ulët. Këto kushte po bëhen gjithnjë e më të zakonshme në pjesë të Evropës për shkak të ndryshimeve klimatike. Speciet *Vibrio* zbulohen shpesh gjatë verës në Detin Baltik, pasi ai ofron kushte veçanërisht të favorshme për rritjen bakteriale për shkak të përqendrimit të ulët të kripës. Bakteret janë gjetur edhe në vende të tjera, duke përfshirë Detin e Veriut dhe vende të ndryshme të mbyllura ose të grykëderdhjes së lumenjve dhe, ndërsa temperaturat e sipërfaqes së detit rriten në të gjithë Evropën, parashikohet që *Vibrio* do të zgjerohet në zona të tjera bregdetare.

8. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

INSITUTI KOMËTAR I SHËNDETËSISË**PUBLIKE TË KOSOVËS****Departamenti i Epidemiologjisë****Adresa: Rr. Nëna Terezë (p.n) rrethi i spitalit, Prishtinë 10000****WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>****E-mail: ariana.kalaveshi@rks-gov.net****Telefoni+38338 551432, ext. 1013**



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS
NATIONAL INSTITUTE OF PUBLIC HEALTH OF KOSOVA